



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të neneve 3.5 pika (ii), 15.1 pika (a), (c), (e), (j), lidhur me nenin 45 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Viti III, Nr. 28, datë 4 qershor 2008),

Duke marrë parasysh,

Obligimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës në lidhje me Marrëveshjen Shumëpalëshe për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (më tutje referuar si "Marrëveshja për HPEA") që nga hyrja e saj e përkohshme në fuqi për Kosovën më 10 tetor 2006,

Rregulloren AAC nr. 4/2015 mbi kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me operimet ajrore me të cilën është shfuqizuar Rregullorja e AAC-së Nr. 9/2011 e datës 28 shtator 2011,

Me qëllim të implementimit të Rregullores së Komisionit (EC) Nr. 2111/2005 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 14 dhjetor 2005 për themelimin e listës së Komunitetit të transportuesve ajror të cilët i nënshtrohen ndalimit të operimeve brenda Komunitetit dhe në lidhje me informimin e aviopasagjerëve për identitetin e transportuesit ajror, dhe shfuqizimin e Nenit 9 të Direktivës 2004/36/EC, në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës,

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik me të gjitha palët e interesuara, në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesuara,

Nxjerr këtë:

RREGULLORE NR. 10/2015
PËR THEMELIMIN E LISTËS SË KOMUNITETIT TË TRANSPORTUESVE AJROR
TË CILËT I NËNSHTROHEN NDALIMIT TË OPERIMEVE BRENDA
KOMUNITETIT DHE NË LIDHJE ME INFORMIMIN E AVIOPASAGJERËVE PËR
IDENTITETIN E TRANSPORTUESIT AJROR

Neni 1

1.1 Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 2111/2005 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 14 dhjetor 2005 për themelimin e listës së Komunitetit të transportuesve ajror të cilët i nënshtrohen ndalimit të operimeve brenda Komunitetit dhe në lidhje me informimin e aviopasagjerëve për identitetin e transportuesit ajror, dhe shfuqizimin e Nenit 9 të Direktivës 2004/36/EC, me tutje e referuar si "Rregullorja e Komisionit", shpallet e zbatueshme në Republikën e Kosovës. Rregullorja e Komisionit i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje si shtojcë dhe formon pjesën e saj përbërëse

1.2 Dispozitat e zbatueshme të Rregullores së Komisionit në Republikën e Kosovës janë Nenet 1 deri 13, dhe Shtojca.

1.3 Çdo dispozitë e amendamenteve të ardhshme të Rregullores së Komisionit, me futjen e saj në fuqi si pjesë e Shtojcës I ose II të Marrëveshjes për HPEA, do të jetë e zbatueshme drejtpërsëdrejti në Republikën e Kosovës.

Neni 2

2.1 Kuptimi i shprehjeve dhe definicionet e përdorura në këtë Rregullore janë të përfshira në Nenin 2 të Rregullores së Komisionit.

2.2 Pavarësisht nga paragrafi 1 shprehjet "Komuniteti", "ligji i Komunitetit", "legjislacioni i Komunitetit", "Instrumentet e Komunitetit", "Traktati i KE", "aeroport i Komunitetit", "Gazeta Zyrtare e Komuniteteve Evropiane", "Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian", "transportues ajror i Komunitetit" dhe "Shtet(e) Anëtar(e)", të cilat mund të referohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi në Rregulloren e Komisionit, duhet të lexohen në përputhje me Pikat 2 dhe 3 të Shtojcës II të Marrëveshjes për HPEA.

2.3 Për qëllim të kësaj Rregulloreje, shprehja "autoriteti kompetent", siç është e referuar në Rregulloren e Komisionit, për organizata të cilat veprimtarinë kryesore të biznesit e kanë në Republikën e Kosovës, do të nënkuptoj Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës; ose "Agjencia Evropiane e Sigurisë së Aviacionit" (më tutje e referuar si "Agjencia") nëse kjo kërkohet nga Republika e Kosovës.

Neni 3

Zbatimi i dispozitave të Rregullores së Komisionit që lidhen me funksionet dhe detyrat e Agjencisë të cilat kryhen në emër të Shteteve Anëtare, sa i përket Republikës së Kosovës do të jenë subjekt i aranzhimeve të punës ndërmjet Agjencisë dhe Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës.

Neni 4

Në rast të interpretimit të Rregullores së Komisionit do të përdoret versioni origjinal në gjuhën angleze siç është i publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Neni 5

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 20 nëntor 2015.

Prishtinë, 6 nëntor 2015

Dritan Gjonbalaj
Drejtor i Përgjithshëm